

AKTI I THEMELIMIT
TË
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
ROOTS CONSULTING SHPK

Sot me datë 1.03.2021, personat e mëposhtëm:

1 - **Znj. Aurora Birbilaj**, shtetase shqiptare, e bija e Irfan, lindur më 15.05.1988, në Tiranë, banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit nr. 035370337 dhe nr. personal I85515090S; madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, me vullnetin e saj të lirë e të plotë, nëpërmjet këtij akti themelon sot një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe kushteve të parashikuara më poshtë.

I.

Krijimi

I.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin ROOTS CONSULTING SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), themelohet në bazë të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

II.

Objekti

II.1 Objekt i aktivitetit të Shoqërisë është:

- (i) ofrimi i shërbimit të konsulences në fusha të ndryshme, si ndertimi dhe operimi i një aktiviteti tregtar dhe biznesi, ndërmarrjeve turistike, trainimeve, këshillimit të personave të tjerë mbi eksperiencat e biznesit në fushat e mesiperme dhe të lidhura;
- (ii) kryerje e transaksioneve në perfaqësimin, përfshirë komercial, të individëve, organizatave dhe / ose institucioneve të huaja në Republikën e Shqipërisë;
- (iii) ndërmjetësimi midis organizatave të sipërpervendura dhe personave fizike dhe / ose juridike ose individëve, ente, subjekteve të çfarëdo forme vendase;
- (iv) ofrimi dhe kryerja e shërbimeve të krijimit dhe ecurisë së aplikacioneve të ndryshme;
- (vi) kryerja e organizimit të agentit të aktivitetëve në lidhje me udhëtimet ose aktivitetet sa më sipër listohet dhe me gjere, sipas lejes/licences/autorizimit përkatës të kërkuar nga legjislacioni;
- (vii) çdo aktivitet tregtar në mbështetje të sa më sipër dhe me gjere, të lejuar nga dhe në zbatim të legjislacionit.

II.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.



III.

Zyra qendrore

- III.1 Zyra qendrore e Shoqërisë është në adresën: Rruga e Barrikadave, Ndertesa 9, Hyrja 4, Ap. 17, Tiranë, Republika e Shqipërisë.
- III.2 Shoqëria mund të hapë zyra dhe/ose të kryejë aktivitetet në vende të tjera si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të organit kompetent ose vendimmarrës.

IV.

Kohëzgjatja

- IV.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

V.

Kapitali Themeltar dhe Ortakët e Shoqërisë

- V.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 200,000 (dyqind mijë) Lekë, perbere nga 1 (nje) kuote, e zotëruar nga ortaku.
- V.2 I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar në para nga ortaku i Shoqërisë.
- V.3 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme midis ortakëve në çdo moment sipas kushteve të parashikuara nga ligji shqiptar.
- V.4 Përgjegjësia e ortakëve për mbulimin personalisht të humbjeve të Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të tyre të nënshkruar në kapitalin e Shoqërisë.
- V.5 Përqindja e pjesëmarrjes së secilit ortak në kapitalin e Shoqërisë është:
- **Znj. Aurora Birbilaj**, shtetase shqiptare, e bija e Irfan, lindur më 15.05.1988, në Tiranë, banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit nr. 035370337 dhe nr. personal I85515090S, zotëruar e 100% të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuote të kapitalit të barabartë me 200.000 Lekë (dyqind mijë) Lekë.
- V.6 Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar, domethënë fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

VI.

Administrimi

- VI.1 Shoqëria administrohet nga një, dy ose më shumë administratorë, persona fizikë të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.



- VI.2 Veprimet e administrimit të Shoqërisë në rast të dy administratorëve do të konsiderohen të vlefshme nëse janë ndërmarrë dhe nënshkruar nga të paktën njëri prej tyre dhe në rast të dy ose më shumë administratorëve veprimet konsiderohen të vlefshme nëse nënshkruhen të paktën nga 2 prej administratorëve të Shoqërisë.
- VI.3 Administratorët emerohen për një periudhë 5 (vjeçare) dhe mund të riemërohen.
- VI.4 Administratori i parë i Shoqërisë emërohet:
Znj. Aurora Birbilaj, shtetase shqiptare, e bija e Irfan, lindur më 15.05.1988, në Tiranë, banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit nr. 035370337 dhe nr. personal I85515090S.
- VI.5 Administratorët shkarkohen/t nga detyra në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.
- VI.6 Kompetencat e administratorit/ëve të Shoqërisë përcaktohen dhe rregullohen në Statutin e Shoqërisë.

VII.

Viti ushtrimor

- VII.1 Viti ushtrimor fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përfundimisht, viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregëtar dhe përfundon më 31 Dhjetor të vitit në vazhdim.

Ky Akt Themelimi është hartuar në 5 (pesë) ekzemplarë në gjuhën shqipe, secila njëllë e vlefshme.

Nënshkruar nga Ortaku Themelues sot më datë 1.03.2021.

ORTAKU THEMELUES

Znj. Aurora Birbilaj

Aurora Birbilaj

